



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i  
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/ Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

Këshilli drejtues, përbërja, kompetencat e tij dhe përbërja e komisionit, mënyra e zgjedhjes së udhëheqësve dhe personelit të institucioneve parashkollore

**NUMËR :1/2008**

**DATË : 3.03.2008**

Në bazë të nenit 1.3 pika ( d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, nenit 13.5 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë , nenit 10.3, 28.7 dhe 49 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij UA është që të përcaktojë përbërjen, kompetencat e Këshillit drejtues të institucioneve parashkollore si dhe përbërjen e komisionit dhe mënyrën e zgjedhjes së udhëheqësve në institucionet parashkollore.

**Neni 2**

**Përbërja e Këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues zgjedhet nga prindërit e fëmijëve të Institucioneve parashkollore.
2. Anëtarët e Këshillit drejtues zgjedhen me kundër kandidatë dhe zgjedhja bëhet me votim të fshehtë.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat 2 vjet me mundësi të rizgjedhjes .
4. Drejtori i IP është sekretar i Këshillit të institucioneve parashkollore dhe ka të drejtë të propozojë.
5. Numri i anëtarëve të Këshillit drejtues përcaktohen në bazë të numrit të fëmijëve në IP dhe sillet prej 5 deri në 7 anëtarë.

### **Neni 3**

#### **Kompetencat e Këshillit drejtues**

Këshilli drejtues i ka këto kompetenca:

1. Hartimi dhe miratimi i planit dhe programit vjetor të punës së institucionit parashkollor.
2. Hartimi i rregulloreve të institucioneve parashkollore të cilat i paraqiten për miratim komunës.
3. Zgjedh një përfaqësues të prindërve dhe një përfaqësues të edukatoreve për të marrë pjesë në zgjedhjen e drejtorit dhe edukatoreve të kopshtit dhe çerdhes sipas procedurave të parapara me ligj.
4. Vendos për caktimin e fondeve me kontribut nga prindërit dhe fondet tjera të siguruara.

### **Neni 4**

#### **Komisioni për përzgjedhjen e udhëheqësve dhe personeli të Institucioneve Parashkollore**

- a) Komisioni për zgjedhjen e drejtorit të IP të themelohet në çdo Komunë dhe përbëhet prej:
  - i. Një përfaqësues të MASHT-it (kryetarë i komisionit)
  - ii. Drejtori Komunal i Arsimit
  - iii. Zyrtari i Lartë i Arsimit (nga sektori që gjeografikisht e mbulon institucion parashkollor)
  - iiii. Një anëtar si vëzhgues nga SBASHK.
- c) Komisioni për zgjedhjen e drejtorit të institucionit parashkollor do të mbështetet edhe nga dy anëtarë konsultativ :
  - i. Një prind nga Këshilli i prindërve të Institucioneve Parashkollore dhe
  - ii. Një përfaqësues i institucionit parashkollor.
- d) Përbërja e Komisionit për përzgjedhjen e personelit të Institucioneve parashkollore
  - i. Drejtori Komunal i Arsimit
  - ii. Zyrtari i Lartë i Arsimit
  - iii. Drejtori i institucionit parashkollor.

## **Neni 5**

### **Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor**

1. Personeli edukativ në institucion parashkollor zgjedhet sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren Nr. 36/2001 Mbi shërbimin Civil të Kosovës si dhe Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 të UNMIK-ut për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36.
2. Komisioni për zgjedhjen e personelit edukativ do të shqyrtoj të gjitha kërkesat e kandidatëve dhe pastaj në bazë të kriterëve (shkalla e përgatitjes profesionale, rezultatet në punë, përvoja e punës në arsim ,etj) do të përpilohet një listë e ngusht prej tre(3) kandidatëve për intervistë.
3. Komisioni do të intervistoj kandidatët e listës së ngushtë një nga një dhe do të vlerësoj ata në bazë të kriterëve.
4. Personelin edukativ në institucion parashkollor, e zgjedh Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në bazë të rekomandimit të komisionit për zgjedhjen e personelit.
5. Në rast të mos zgjedhjes së kandidatit të renditur i pari me poena, DKA duhet të jap arsyet e një vendimi të tillë.

## **Neni 6**

### **Mënyra e zgjedhjes së drejtorit**

1. MASHT-i bën zgjedhjen e udhëheqësve në institucionet parashkollore publike, kurse në institucionet private e bën themeluesi i institucionit .
2. Zgjedhja e drejtorëve në institucionet parashkollore bëhet në procedurën e njejtë siç është paraparë në nenin 13.5 dhe 24.2 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Udhëzimin administrativ nr.19/2002 për Procedurën e zgjedhjes së drejtorit, „Aneksit –I- nr.8/2003 si dhe Aneksit –II- me nr. 1/2007 të këtij Udhëzimi administrativ.

## **Neni 7**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij .

---

**Enver Hoxhaj, ministër**